

NË EMËR TË POPULLIT

Më  
Dana  
26  
2018

**GJYKATA THAMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm –  
Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja  
individuale Hakile Ilazi me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në  
lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED] për shkak të veprës penale vjedhje e  
rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1 të KPRK-së dhe [REDACTED] për shkak të veprës  
penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1  
nënp.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1837-  
3/16 të datës 05.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.05.07.2017, në prani  
të prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] të  
dëmtuari [REDACTED] dhe përfaqësuesit të tij av [REDACTED] shpall dhe publikisht  
komunikon këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari [REDACTED], nga fshati [REDACTED] K. Kaçanik, i lindur me datë  
[REDACTED] në [REDACTED] në Zvicërr, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka  
të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar,  
shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] K. Kaçanik, i lindur me datë  
[REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të  
kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, instalues i  
ujësjellësit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTORË**

**I pandehuri [REDACTED]**

Se me dt.05.09.2013 rreth orës 22,30 në fshatin [REDACTED] K.Ferizaj, në shtëpinë e të  
dëmtuarit [REDACTED], me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e  
që vetit të i sjell përfitim pasuror të kundërligjshme, me përdorimin e forcës ka hapur

dritaren e katit ka depërtuar brenda dhe nga aty ka marrë rreth 4700 CHF si dhe sasi ari në vlerë të konsiderueshme, një revole e markës "HS 9" ku më vonë hetohet nga ana e policisë dhe disa prej sendeve të vjedhura i konfiskohen,

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1 të KPRK-së,

I pandehuri [REDAKTUAR]

Me datën 05.09.2013 rreth orës 22:30, në fshatin [REDAKTUAR] K. Ferizaj i ka ndihmuar të pandehurit të parë në atë mënyrë që pas kryerjes së veprës penale të vjedhjes e ka ndihmuar atë në fshehjen e sendeve të vjedhura, mjeteve, provave duke i dërguar në shtëpinë e tij më vonë ku më vonë është hetuar dhe janë konfiskuar nga ana e policisë,-

me të cilën ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KPRK-së,

Andaj gjykata në baze të neneve 4,7,17,21,41,46,51,73 si dhe neni 365 të KPRK-së, iu shqipton:

GJYKON

Të pandehurit [REDAKTUAR]

DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 1/NJË/VITI , dënim i cili nuk do të ekzekutohen në rast se i akuzuari brenda 2/dy/viteve nga dita e

plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit) dhe

**DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 2000/dy mijë/ euro, duke ju llogaritur koha e kaluar në arrestin shtëpiak nga data 06.09.2013 e deri më datë 06.10. 2013**

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Të pandehurit [REDAKTUAR]

**DENIM ME GJOBË NË SHUMËN PREJ 300/TRE QIND/EURO**

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obliqohen të akuzuarit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën me nga 30 /tridhjetë euro /€ në afat prej 30 ditësh nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

## Arsy etimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.1837-3/13 të datës 05.05.2014, ka akuzuar të akuzuarve [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar.1 të KPRK-së dhe [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 1 nënpar.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 05.07.2017, në të cilën shqyrtim të akuzuarit janë deklaruar fajtor për veprën për të cilën i ngarkon akuza.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 326 lidhur me nenin 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: deklarata e të dëmtuarit e datës 06.09.2013, deklarata e të pandehurve të datës 06.09.2013, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 06.09.2013, dëshmitarit [REDAKTUAR] vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i datës 16.08.2013.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata konform nenit 326 lidhur me nenin 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se jep mendim për pranimin e fajësisë ndaj të pandehurve pasi që ky pranim mbështetet në faktet dhe provat e çështjes, gjithashtu i propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe përcaktimit dhe llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit av. [REDACTED] nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së të akuzuarve, mirëpo kërkon nga gjykata që pranimi fajësisë të mos merret si rrethanë posaçërisht lehtësuese nga fakti se i akuzuari i parë i cili ka vjedhur sendet në shtëpinë e të dëmtuarit nuk ika kthyer të gjitha, por i ka kthyer vetëm revolen e tipit HS.9 e cila e kishte vlerën 1190/njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë / euro si dhe arrin në tersi në vlerë prej 7500/shtatë mijë e pesëqind/ euro ndërsa kanë mbetur pa u kthyer 4700/katërmijë e shtatëqind franga/, 400/katërqind dollar/, 1500 /njëmijë e pesëqind euro/ si dhe sistemi i alarmit me kamera me vlerë prej 2000/dymijë euro/.

I pandehuri [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se shpreh keqardhje dhe është penduar thellë duke shtuar se në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale ka qenë i moshës së re por potencon e dhe faktin se është mbikëqyrës i familjes ka një fëmijë dhe është duke e pritur edhe një fëmijë, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, e lut gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

I pandehuri [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se shpreh keqardhje dhe është penduar thellë duke shtuar se në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale ka qenë i moshës së re, është mbajtës i familjes, babë i 4 fëmijëve, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, e lut gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDACTED] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës **vjedhje rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1 të KPRK-së**, ndërsa në veprimet e të akuzuarit [REDACTED] ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale **dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KPRK-së**.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin [REDACTED], Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, shpreh keqardhjen dhe është i penduar thellë për veprën e kryer, ka qenë i moshës relativisht te re në kohën e kryerjes së veprës penale, mbajtësi familjes, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, nuk

është i evidentuar më parë si kryerës i veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Ndërsa sa i përket të akuzuarit [REDAKTUAR] Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, shpreh keqardhjen dhe është i penduar thellë për veprën e kryer, baba i katër fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, ka qenë i moshës relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, mbajtësi i familjes, sjelljen korrekte gjatë tërës procedurës, nuk është i evidentuar më parë si kryerës i veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprave penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së, i dëmtuari [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohen të akuzuarit që secili në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë /€ në afat prej 30 ditësh

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.509/14 me datë 05.07.2017**

**Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Bytyqi Rexhepi**

**Gjyqtarja,  
Hakile ILAZI**



**Këshilla juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.